



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHIJAK**  
**SEKTORI JURIDIK**

**Shijak, më 08 . 01 . 2018**

**Dokumentat që duhet të paraqiten për përfitim burse për studentët që ndjekin studimet në IAL Publike, Të regjistruar në vitin e parë akademik në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve më karakter profesional dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në Institucionet e arsimit të Lartë Publik, për vitin akademik 2017-2018**

**Bashkia Shijak**, Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 903 , datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentë e shkëlqyer, studentë që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentë në nevojë”, i ndryshuar;

**NJOFTON për paraqitje dokumentacioni dhe përfitim të bursave sipas kriterëve si më poshtë vijon :**

1. Studentët e shkëlqyer, me notë mesatare maksimale nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, që ndjekin studimet në një program studimi të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë, përfitojnë bursë në masën e parashikuar në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Notë mesatare maksimale do të konsiderohet nota 10 (dhjetë), e përlogaritur si mesatare e notave të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, përfshirë dhe rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore. Lista e studentëve të shkëlqyer hartohet nga Agjencia Kombëtare e Provimeve.

2. Për studentët e regjistruar në vitet pas të parit, notë mesatare maksimale do të konsiderohet nota 10 (dhjetë), e përlogaritur si mesatare e notave të të gjitha provimeve/detyrimeve të shlyera dhe të parashikuara për programin përkatës të studimit për vitet pararendëse. Këta studentë duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitet e mëparshme të programit të studimit përkatës, brenda përfundimit të vitit akademik paraardhës.

3. Bursat e studimit për studentët, të cilët kanë zgjedhur të ndjekin programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar në institucionet publike të arsimit të lartë, të shpallura të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave, u shpërndahen studentëve që studiojnë në këto programe dhe institucione, sipas masës së përcaktuar në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Studentët që frekuentojnë këto programe studimi e përfitojnë bursën vetëm për periudhën që ndjekin studimet në fushat prioritare dhe për kohëzgjatjen normale të programit të studimit.

Studentëve të regjistruar në programet e ciklit të parë të studimeve në programet e studimeve me karakter profesional dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në

institucionet e arsimit të lartë publik dhe që u përkasin shtresave sociale në nevojë, u akordohen bursa kur ata plotësojnë kriteret për t'u konsideruar si studentë në nevojë.  
Studentë në nevojë konsiderohen:

**Sipas kriterit ekonomik:**

1. Studentët që ndjekin studimet në largësinë mbi 10 ( dhjetë ) km nga vendbanimi i tyre i përhershëm, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike nga njësia e vetëqeverisjes vendore;
2. Secili nga studentët, i cili rezulton bashkëshort me fëmijë, dhe kur familja e tij trajtohet me ndihmë ekonomike nga njësia e vetëqeverisjes vendore;
3. Personat me aftësi të kufizuar, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar;

**Jashtë kriterit ekonomik:**

1. Studentët me statusin e jetimit të paraqesin vërtetim për këtë status nga zyra e shërbimit social shtetëror pranë ministrisë së punës;
2. Studentët që e kanë humbur kujdestarinë prindërore të paraqesin vendimin e gjykatës së formës së prerë;
3. Studentët që janë identifikuar dhe trajtuar si viktimat të trafikut të qënieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror të paraqesin dokumentat që vërtetojnë këtë status;
4. Studentët, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës të paraqesin dokumentat që vërtetojnë këtë status.

**Studentët nuk përfitojnë bursë apo humbasin të drejtën e përfitimit në rast se:**

1. Janë ndarë nga trangu familjar;
2. Familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private;
3. Vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi;
4. Shpallen ngelës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokaluese;
5. Nuk kanë përfunduar programin e studimit brenda kohëzgjatjes normale të tij, të përcaktuar në aktin e hapjes së programit përkatës të studimit.

*Shënim : Dokumentat të jenë të tre muajve të fundit dhe dorëzimi i tyre bëhet pranë Zyrës së*

**Afati përfundimtar i pranimit të dokumentacionit është data 17.01.2018**

Konceptoi:A. Mehmeti  
Pranoi :E.Osmanaj

**KRYETARI  
ARDIAN KOKOMANI**